

ANILA SHORRI

**VENDI I HUAZIMEVE GREKE NË FJALORËT SHPJEGUES
TË GJUHËS SHQIPE (1954-1980-2006)**

Qëllimi i studimit: Objekt i këtij punimi është bërë shtresa e huazimeve greke të pranishme në leksikun e shqipes, ndërsa synimi ka të bëjë me shqyrtimin tërësor të greqizmave në shqipë, për të parë vendin e tyre në fjalorët shpjegues të shqipes (Janë realizuar pasqyra krahasuese për vendin që zënë greqizmat në fjalorët e shqipes, pasqyra këto që shoqërohen me komente e analiza për sasinë dhe cilësinë e greqizmave në fjalor.).

Metodologjia e studimit: Për përgatitjen e këtij punimi është vjelë me kujdes shtresa leksikore e greqizmave nga vepra “Studime gjuhësore” e profesor E. Çabejt. Po kështu, këtë shtresë fjalësh e kemi vjelë nga fjalorët shpjegues të shqipes, botuar në vite të ndryshme përkatësisht 1954, 1980 dhe 2006.

Nëpërmjet këtij punimi synohet të sillen disa vëzhgime krahasuese, si gjuha shqipe është zhvilluar dhe nuk e ka ndjerë më nevojën e përdorimit të këtyre greqizmave duke i zëvendësuar me fjalë e shprehje të gurës sonë popullore dhe ashtu siç e kërkon zhvillimi i shoqërisë. Kështu, fjalë të tilla si: *leshkorre*, *kallamboq*, *vajë*, *jajë*, *djimen*, *bajloz*, *dërhëm*, *krusmë*, etj..., të cilat i përfshinte si të vendit fjalori i vitit 1954 dy botimet e tjera i përfshijnë ose si fjalë të vjetruara ose si fjalë krahinore.

Fjalët që përdoren në gjuhë në një epokë të caktuar të saj janë dëshmi e gjallë e fateve historike të popullit që e flet dhe e ka folur, dëshmi e gjallë e ndikimeve që ka pësuar gjuha në rrymën e kohëve nga gjuhë të tjera ose që ka ushtruar mbi to. Ndaj edhe leksiku vetjak i gjuhës së një populli - i parë historikisht - përbën një dokument të dorës së parë për historinë e çdo populli. Fjalët, si shprehje gjuhësore e gjërave konkrete e abstrakte, e sendeve dhe e koncepteve që jetojnë te një popull, në mënyrën si janë ngjeshur nga burimi vetjak i gjuhës së tij, janë edhe pasqyrë e kulturës materiale e shpirtërore.

Në këto kushte, kuptohet mjaft mirë rëndësia që ka etimologjia për historinë e kulturës, për prehistorinë dhe etnografinë, e anasjelltas, edhe rëndësia që kanë këto disiplina për studimet e etimologjisë dhe sidomos të gjuhësisë.

Gjuha shqipe është nga të paktat gjuhë indoevropiane që ka pasur fatin të ketë një fjalor etimologjik që nga shekulli i kaluar. Fjalori, i botuar nga gjuhëtari i madh G. Meyer, mbetet edhe sot një vepër themelore për çdo lloj studimi në fushën e shqipes, madje përtej saj, edhe për gjuhësinë ballkanike. Megjithatë, sot, me zhvillimin e gjuhësisë shqiptare, për dy arsye shumë objektive është nevoja për ta rishikuar këtë vepër.

1) Arsyeja e parë ka të bëjë me pasurimin e njohjes së leksikut të shqipes, qoftë nëpërmjet fjalorëve që janë botuar, qoftë nëpërmjet monografive a skicave dialektore.

2) Arsyeja e dytë ka të bëjë me zhvillimin e gjuhësisë shqiptare si nga emra të vendit, por edhe nga gjuhëtarë të huaj.

Në një studim të detajuar që i është bërë kësaj vepre në këtë punim, është vërejtur se autori i saj, nga materiali që ka marrë në shqyrtim, ka veçuar fjalët e burimit të trashëguar nga ato me burim të huaj. Kështu, nga korpusi i fjalëve të sipërpërmendura, vetëm rreth 135 fjalë mund të merren si huazime të shqipes nga gjuha greke.

Nga përdorimi i këtyre fjalëve nëpër fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, botuar në vite të ndryshme, janë vërejtur disa përshtatje morfologjike e kuptimore mjaft interesante, duke filluar nga Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954, natyra e të cilit i vinte disa kufij numrit të fjalëve. Po kaq interesante është në këtë fjalor edhe vendosja e fjalëve të dala si huazime në “Studime gjuhësore”. Për rreth 135 fjalë si huazime në veprën e mësipërme, 35 fjalë ky fjalor nuk i trajton, ndërsa pjesën tjetër i trajton si fjalë vendi, pa ndonjë shënim përkatës për të vënë në dukje huazimin.

Nga grupi i fjalëve të dyta të bie në sy se këto janë më të mëdha në krahasim me të parat, por edhe kjo është e kuptueshme, pasi në këtë vit gjuha shqipe, me gjithë punën e palodhur, në radhë të parë të rilindësve e më pas të gjuhëtarëve më të kualifikuar, ishte në kushte modeste të zhvillimit të saj.

Ky është një fakt i pamohueshëm që vërehet në përgatitjen e Fjalorit të gjuhës shqipe të vitit 1980 - fjalor i tipit të mesëm – i cili synonte të zgjidhte njëkohësisht dy detyra:

a) të jepte shpjegimet dhe normat e përdorimit të fjalëve e të shprehjeve që kishin zënë vend të qëndrueshëm në gjuhën e sotme letrare shqipe;

b) të hidhte në përdorim fjalë pak të njohura ose të panjohura, sidomos të gurrës popullore, që nuk ishin të pasqyruara në fjalorë e në botime të tjera, por që duhej të ishin pjesë e pandarë e fondit leksikor e frazeologjik të gjuhës sonë letrare kombëtare.

I parë imtësisht në këtë punim, fjalori ka një hapësirë të konsiderueshme për fjalët e dala si huazime në veprën “Studime gjuhësore” të prof. E. Çabej. Nga rreth 135 fjalët e gjetura si huazime, shpërndarja e tyre në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, rreth 55 fjalë nuk i trajton fare. Në këtë punim, janë studiuar vetëm fjalët e përgjithshme të para si huazime nga greqishtja në veprën “Studime gjuhësore” të prof. E. Çabej (Me emërtimet e përveçme do të merremi në një tjetër punim).

Nga një vëzhgim kujdesshëm i vendit që zënë këto fjalë në fjalorin e mësipërm, shihet qartë se numri i fjalëve të lëna jashtë tij është shumë herë më i madh, po ta krahasojmë me Fjalorin e vitit 1954, edhe pse numri i fjalëve që përmban ky fjalor është disa herë më i madh sesa i pari.

Duke pasur parasysh luftën e rilindësve për të pasuruar dhe pastruar gjuhën shqipe nga fjalët e vjetruara, mendoj se kjo ka qenë arsyeja e mospërfshirjes së

këtyre fjalëve. Madje, një ndër parimet bazë, që u ndoq mbi huazimet në këtë fjalor, kishte të bënte me faktin që fjalori do t'i trajtonte fjalët e huaja në mënyrë mjaft të kufizuar dhe vetëm atëherë kur do të ishin të domosdoshme.

Ndërsa, një botim tjetër, "Fjalori i gjuhës shqipe", botim i vitit 2006, përfshin shtresën kryesore, më aktive të leksikut të gjuhës së sotme shqipe dhe një pjesë të kufizuar, krejt të domosdoshme, të shtresës pasive. Si parim themelor në ndërtimin e këtij fjalori është ruajtja e simetrisë ndërmjet strukturës leksikore dhe strukturës semantike. Fjalori i drejtohet një rrethi të gjerë përdoruesish, pra ka më shumë synime praktike sesa fjalorët e mëparshëm shpjegues të shqipes.

Nisur nga disa parime bazë të ndërtimit të këtij fjalori dhe realitetit gjuhësor që ai paraqet, është evident vendi i huazimeve në veprën leksikografike të E. Çabejt.

Nga rreth 135 fjalët e gjetura si huazime në veprën e mësipërme, 67 fjalë ky fjalor nuk merr përsipër që t'i shpjegojë.

Gjykoj që në vitin 1954, huazimet jo vetëm nga greqishtja, por edhe nga shumë gjuhë të tjera kanë qenë të pashmangshme, për vetë shkaqet e theksuara më sipër.

Ndryshe qëndron puna në ndërtimin e Fjalorit të vitit 1980, kur gjuhësia kishte bërë hapa përpara, por edhe kur puna e rilindësve u vazhdua më tej.

Me hapjen e kufijve, pas vitit '90, shoqëria shqiptare u hap dhe gjuha u zhvillua (këtu bëhet fjalë për pjesën jugore, por jo vetëm për shkak të emigracionit), ka dhënë e ka marrë pasuri gjuhësore me popullin grek, kështu që u rizgjuan edhe fjalët e harruara. Madje, në zona të Shqipërisë së Jugut, fjalët filluan të përshtaten jo vetëm në popullsinë e krishterë, por edhe në atë myslimane, për shkak të qëndrimit në shtetin fqinjë (*Hajde te jajaja, jepja kokon jajasë*, etj). Sigurisht, ky shembull nuk na bën të ndihemi krenarë, por është realitet i hidhur.

Nga përfshirja e fjalëve të patrajuara më sipër, shohim se numri i tyre është rritur, gjë që vërteton se gjuha shqipe është zhvilluar, pastruar e pasuruar me fjalë të reja në rrjedhë të kohës dhe këtu vlen të përmendet puna e gjuhëtarëve që nga Rilindja e deri në ditët tona, si edhe vetë zhvillimi që ka marrë shoqëria shqiptare, duke mos e parë të arsyeshëm përdorimin e këtyre fjalëve.

Nëse në fjalorin e parë të marrë në shqyrtim, ishin rreth 35 fjalë të papërfshira, në fjalorin e dytë ky numër shkon në rreth 55, ndërsa në botimin e tretë shkon në rreth 65 fjalë të papërfshira.

I kthehemi vështrimit krahasues për fjalët e huazuara të shqipes nga greqishtja, të cilat sot janë të përfshira si fjalë vendi të shqipes. Numri i këtyre fjalëve në fjalorin e botimit të parë shkonte rreth 100 fjalë, ndërsa në botimin e fjalorit të dytë dhe të tretë ky numër zbret me rreth 40 fjalë, shifër që e çon në rreth 60 fjalë numrin e fjalëve të huazuara të gjuhës shqipe nga greqishtja (në të tri periudhat kohore të ndarjes së tyre; greqishtja e hershme, e mesme dhe e re).

Kjo shifër në rënie, mendoj se ka argumentin e vet:

Gjuha shqipe është zhvilluar dhe nuk e ka ndjerë më nevojën e përdorimit të këtyre fjalëve si të vetat, duke i zëvendësuar me fjalë e shprehje të gurës sonë popullore dhe ashtu siç e kërkon zhvillimi i shoqërisë. Kështu, fjalë të tilla si;

leshkorrë, kallamboq, vajë, jajë, djimen, bajloz, dërhem, krusmë, etj., të cilat i përfshinte si të vendit Fjalori i vitit 1954, dy botimet e tjera i përfshijnë ashtu siç edhe e kemi sqaruar më sipër ose si fjalë të vjetruara ose si fjalë krahinore.

Pasqyrë krahasuese e huazimeve greke në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe

Nr.	F J A L A	F J A L O R I		
		1954	1980	2006
1	Akól	-	-	-
2	Arbër	-	+	+
3	argsh	+	+	+
4	arzë	+	+	+
5	arratis	+	+	+
6	avaní	-	+	-
7	bagëm	+	+	-
8	bajlóz	+	+	+
9	balastrí	-	+	-
10	barbùn	+	+	+
11	bastùn	+	+	+
12	bletë	+	+	+
13	cangadhe	+	+	+
14	caruqe	+	+	+
15	cfrat	+	-	-
16	ciknë	+	-	-
17	cikofúa	+	+	+
18	cuks	+	+	+
19	demét	+	+	+
20	dërhém	+	+	+
21	djemën	+	+	+
22	dorbëri	-	+	-
23	drapër	+	+	+
24	drum	+	-	-
25	dhiglë	-	-	-
26	dhimisiqi	+	-	-
27	dhiqél	+	+	+
28	dhokán	+	-	-
29	enemi	+	-	+
30	fagurë	-	-	-
31	fagusë	-	-	-
32	falís	+	-	-
33	fanitet	+	+	+
34	faqéll	+	+	-
35	faqól	-	-	-
36	fasule	+	+	+
37	fidhës	-	+	+
38	fillikát	+	+	-
39	flori	+	+	+
40	fqollë	+	+	-
41	frangji	+	-	-
42	franxhollë	+	+	+

Vendi i huazimeve greke në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe

43	fratí	+	+	+
44	furqetë	+	+	+
45	gllaro	-	-	-
46	grëmëratë	-	-	-
47	gjoní	+	-	-
48	hierore	+	-	-
49	Hír	-	+	+
50	holás	-	-	-
51	humë	-	-	-
52	ikonë	+	+	+
53	Ja	+	+	+
54	Jajë	+	-	+
55	jerm	+	+	+
56	kadoriqe	+	+	+
57	kallamboq	+	+	+
58	kallm	+	+	+
59	kallogjër	+	+	+
60	kallume	+	+	-
61	kamere	+	+	-
62	kanakúr	+	+	+
63	kandërr	+	+	+
64	kartë	+	-	-
65	Kem	+	+	+
66	Keq	+	+	+
67	koqe	+	+	+
68	kothom	+	-	-
69	krezm	+	+	+
70	krusmë	+	+	+
71	kumbull	+	+	+
72	kurtinë	+	-	-
73	lavinj	-	-	-
74	lepër	-	-	-
75	Lerë	+	+	+
76	leshkorre	+	+	+
77	levrek	+	+	+
78	lukuni	+	+	+
79	mendull	-	-	-
80	metéh	+	-	-
81	mëllagë	+	+	+
82	mëngër	+	+	-
83	mështekër	-	+	+
84	milák	+	+	+
85	ngastër	+	+	+
86	ngos	+	+	+
87	okër	+	+	+
88	palëhúar	-	-	-
89	paramanë	+	+	+
90	parriz	+	-	-
91	Pat	+	-	-

ANILA SHORRI

92	patështinë	+	+	-
93	pellg	+	+	+
94	pezëm	+	+	+
95	pellás	-	-	-
96	pëllëmbë	+	+	+
97	perqí	+	+	+
98	pjekët	+	+	+
99	podhë	+	-	-
100	radhë	+	+	-
101	remë	+	-	-
102	rókëzë	-	-	-
103	rrëfëj	+	+	+
104	sqimë	+	+	+
105	shkallme	+	-	+
106	shkop	+	+	+
107	shpërgâ	+	-	-
108	shqeme	+	+	+
109	shqind	+	+	+
110	shtamë	+	+	-
111	shtupë	+	+	+
112	tarogzë	+	-	-
113	telozna	+	+	-
114	tepë	+	+	-
115	tërfojë	+	-	-
116	trumzë	+	+	+
117	therokë	-	+	+
118	uvje	+	+	+
119	ushûj	+	+	+
120	vagjëli	+	+	-
121	vajë	+	+	+
122	vargër	+	+	+
123	vasilikó	-	-	-
124	visár	+	+	+
125	vivár	+	+	-
126	vrikë	-	+	-
127	xhavidhe	+	-	-

BIBLIOGRAFI

- E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1958.
E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes I*, Tiranë, 1982.
E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II*, Tiranë, 1982.
E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 1954.
E. Çabej, *Studime gjuhësore II*, Prishtinë, 1954.
Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, 1980.
J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
J. Thomai, *Prejardhja kuptimore*, Tiranë, 1989.
Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988.
Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.